

Vendim nr. 177 datë 30.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Marjana Semini, Anëtare

Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 30.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (D) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: DEDË LUF AJ, përfaqësuar nga avokat Bujar Hoti, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 155 (664), datë 18.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 565, datë 16.10.2017 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2023-1648, datë 17.10.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 18, 30, 31, shkronja “d”, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 155 (664), datë 18.02.2016, ka deklaruar fajtor kërkuesin Dedë Lufaj për veprat penale të vrasjes me paramendim në

tentativë dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 78, 22 dhe 278, paragrafi i katërt, të Kodit Penal (KP) dhe në bashkim të dënimeve, bazuar në nenin 55 të këtij kodi e ka dënuar përfundimisht me 25 vjet burgim.

2. Mbi bazën e apelit të kërkuarit, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 565, datë 16.10.2017, ka vendosur ndryshimin e pjesshëm të vendimit vetëm për akuzën e mbajtjes pa leje të armëve luftarake, duke e cilësuar atë sipas paragrafit të parë të nenit 278 të KP-së dhe duke e ulur dënimin për këtë akuzë nga 10 vjet në 4 vjet burgim. Për rrjedhojë, në bashkim të dënimeve, gjykata e apelit e ka dënuar përfundimisht kërkuarin me 16 vjet burgim. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuari.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1648, datë 17.10.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

4. Në datën 13.05.2024 kërkuari, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000 dhe është regjistruar në datën 31.05.2024.

II

Pretendimet e kërkuarit

5. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se prej vendimeve të kundërshtuara i janë cenuar:

5.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës në drejtim të:

5.1.1 *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi Gjykata e Lartë, bazuar në dispozitat e KPP-së nuk duhej ta shqyrtonte çështjen në dhomën e këshillimit, por në seancën gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve.

5.1.2 *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat e faktit nuk kanë pranuar të marrin provat e kërkuara nga mbrojtja, të cilat do të provonin se ngjarja ishte simuluar nga familja e të dëmtuarve dhe rrjedhimisht do të vërtetohej pafajësia e kërkuarit. Në këtë mënyrë, kërkuari i është mohuar *e drejta për t'u mbrojtur* dhe parimi i *barazisë përpara ligjit*.

5.1.3 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi gjyqtarët që kanë shqyrtuar çështjen e kërkuarit nuk janë caktuar me short. Gjatë gjykimit në shkallë të parë, edhe pse trupi gjyqësor është caktuar fillimisht me short, pas dorëheqjes së dy gjyqtarëve për shkak papajtueshmërie, gjyqtarët zëvendësues janë caktuar me vendim administrativ të kryetarit të

gjykatës. Edhe gjatë gjykimit në shkallë të dytë, pas largimit të gjyqtarës së caktuar me short, gjyqtarja zëvendësuese është caktuar me vendim administrativ të kryetarit të gjykatës.

- 5.2. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë dhënë vendimet e kundërshtuara bazuar në paragjykimin se kërkuesi kishte motiv për kryerjen e veprës penale, hakmarrjen për vrasjen e vëllait të tij, ndaj procesi penal është zhvilluar me bindjen se ai e ka kryer veprën për të cilën akuzohej. Kërkuesi është dënuar vetëm mbi bazën e një dëshmie dashakeqe dhe disa indicieve, por pa u provuar fajësia e tij jashtë çdo dyshimi.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

6. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Duke verifikuar kriteret paraprake në çështjen konkrete, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “F” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës. Ai kundërshton procesin gjyqësor, në të cilin është vendosur fajësia dhe dënimi penal i tij, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës, Gjykata ka pohuar se ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet

që ngre në ankimin e tij kushtetues t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Mbi bazën e këtij standardi, Kolegji konstaton se pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, kërkuesi nuk e ka ngritur më parë në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, por e ka parashtruar për herë të parë atë në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive për këtë pretendim, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

11. Për sa u takon pretendimeve të tjera, kërkuesi i ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe përmbajtje, për rrjedhojë e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive.

12. Në lidhje me kriterin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000, parashikon se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Kur individi i drejtohet Gjykatës pas përfundimit të procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar i është njoftuar elektronikisht kërkuesit, nëse ai ka depozituar të dhënat e kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Mbi bazën e këtij standardi, Kolegji konstaton se procesi gjyqësor i kundërshtuar ka përfunduar me vendimin e datës 17.10.2023 të Gjykatës së Lartë, i cili i është komunikuar mbrojtësit të kërkuesit nëpërmjet postës elektronike në datën 15.01.2024. Duke mbajtur në konsideratë se ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 13.05.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

14. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së procesit të rregullt ligjor (në aspektet e së drejtës për t'u dëgjuar dhe të parimit të barazisë së armëve), si dhe të parimit të prezumimit të pafajësisë, të garantuara respektivisht nga nenet 42 dhe 30 të Kushtetutës.

15. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë nuk duhej ta shqyrtonte rekursin e tij në dhomën e këshillimit, por kishte detyrimin ta shqyrtonte në seancën gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve. Kolegji thekson se në jurisprudencën kushtetuese është pohuar në mënyrë konstante se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Nëse Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes

gjqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Kolegji, duke mbajtur në konsideratë se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit, çmon se ajo ka vepruar sipas funksionit të saj, në përputhje me parashikimet ligjore, ndaj pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar nga Gjykata e Lartë është haptazi i pabazuar.

16. Kolegji vëren se kërkuari ka pretenduar, gjithashtu, se është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, duke parashtruar se gjykatat e faktit nuk kanë pranuar të marrin provat e kërkuara nga mbrojtja (dëshmitarë dhe aktekspertimi), të cilat do të vërtetonin pafajësinë e tij. Po kështu, sipas tij, procesi penal është bazuar vetëm në provat e prokurorit, të cilat nuk vërtetojnë fajësinë e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, për rrjedhojë kërkuarit i është cenuar edhe parimi i prezumimit të pafajësisë.

17. Gjykata ka pohuar se parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 13, datë 24.04.2018; nr.68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi bazën e këtij standardi, Kolegji vlerëson t'i shqyrtojë të lidhura së bashku pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe parimit të prezumimit të pafajësisë.

18. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar rëndësia që ka respektimi i parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit veçanërisht në gjykimin penal, pasi lidhen ngushtë me mbrojtjen e të pandehurit dhe përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme të procesit të rregullt ligjor. Këto parime presupozojnë që secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e vënë në disavantazh me palën tjetër (*shih vendimet nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 23, datë 23.07.2009; nr. 10, datë 02.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka pohuar se kërkesa për një gjykim të drejtë nuk i imponon gjykatës detyrimin për të lejuar kryerjen e një ekspertimi ose të ndonjë veprimi tjetër hetimor vetëm sepse një palë e ka kërkuar atë. Kur mbrojtja insiston që gjykata të dëgjojë një dëshmitar ose të marrë prova të tjera (si p.sh. lejimi i ekspertimit), u takon gjykatave vendase të vendosin nëse është e nevojshme t'i pranojnë ato prova për shqyrtim në gjykim. Gjykata vendase është e lirë, me kusht që të respektohen dispozitat e KEDNJ-së, që të refuzojë thirrjen e dëshmitarëve të propozuar nga mbrojtja (*shih Huseyn dhe të tjerët k. Azerbajxhanit, datë 26.07.2011, § 196; Khodorkovskiy dhe Lebedev k. Rosisë, datë*

25.10.2013, §§ 718-721; *Poletani dhe Azirovik k.ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, datë 12.05.2016, § 95*).

20. Po kështu, sipas GJEDNJ-së, refuzimi për të dëgjuar dëshmitarë ose për të shqyrtuar provat e kërkuara nga mbrojtja, ndërkohë që lejohet marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe shqyrtimi i provave të prokurorisë, mund të krijojë një problematikë në këndvështrim të parimit të barazisë së armëve (*shih Borisova k. Bullgarisë, datë 21.12.2006, §§ 47-48; Topić kundër Kroacisë, datë 10.10.2013, § 48*). Për të përcaktuar nëse procedurat kanë qenë të drejta, duhen analizuar këto kritere: (i) nëse kërkesa për marrjen në pyetje të një dëshmitari ka qenë e arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe nëse ka qenë e rëndësishme për objektin e akuzës; (ii) nëse gjykatat e kanë konsideruar rëndësinë e asaj dëshmie dhe kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme vendimin e tyre për të mos marrë në pyetje një dëshmitar në gjykim; (iii) nëse vendimi i gjykatave vendase për të mos marrë në pyetje një dëshmitar e ka dëmtuar në mënyrë të përgjithshme procesin e rregullt (*shih Abdullayev k. Azerbajxhanit, datë 07.03.2019, §§ 59-60*).

21. Ndërsa në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë, neni 30 i Kushtetutës parashikon se kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykata ka theksuar se ky parim ka kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimin nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji vëren se ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, gjykatat e zakonshme e kanë dhënë vendimin e fajësisë për kërkuesin bazuar mbi një sërë provash të shqyrtuara në seancë, të cilat janë vlerësuar në harmoni me njëra-tjetrën. Kështu, nga përmbajtja e vendimeve të gjykatave të faktit, rezulton se janë analizuar një numër i konsiderueshëm dëshmish, këqyrja e vendit të ngjarjes e shoqëruar me tabelën fotografike, provat materiale të sekuestruara, ekspertimi teknikobalistik, këqyrja e sistemit TIMS, tabulatet telefonike, transkriptime të përgjimeve telefonike etj., të cilat janë çmuar në lidhje organike me njëra-tjetrën, që konfirmojnë saktësinë e tyre. Po kështu, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, gjykata e shkallës së parë ka pranuar kërkesën e mbrojtjes për shqyrtimin si provë të tabulateve telefonike të datës së ngjarjes dhe të dhënat e kompanisë celulare për koordinatat e të dëmtuarve, kallëzuesit dhe kërkuesit, nga shqyrtimi i të cilave është provuar e kundërta e fakteve të pretenduara nga mbrojtja. Ndërsa lidhur me kërkesën e mbrojtjes për thirrjen e ekspertëve kriminalistë për rindërtimin e vendit të ngjarjes, gjykatat e faktit kanë arsyetuar se ishte e panevojshme në kushtet kur Policia Gjyqësore kishte bërë një këqyrje të saktë dhe të

plotë të vendit të ngjarjes, e shoqëruar me pamje filmike dhe me skicën përkatëse, në të cilën janë fiksuar provat dhe pozicioni i secilës prej tyre.

23. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se pretendimet e ngritura në të nuk u referohen shkaqeve të përcaktuara në nenin 432 të KPP-së, duke u shprehur se gjykatat e faktit i kanë çmuar provat në tërësi pa mbivlerësuar ndonjërin prej tyre, si dhe kanë arritur në përfundimin për fajësinë e kërkuarit pasi kanë analizuar të dhënat e përfuara nga provat e shqyrtuara. Këto të dhëna, sipas saj, përkojnë me njëra-tjetrën dhe janë të tilla që krijojnë bindjen përtej çdo dyshimi të arsyeshëm në fajësinë e kërkuarit.

24. Në analizë të sa më sipër, Kolegji vëren se gjykatat e zakonshme kanë vendosur për rrethin e provave që duhet të pranoheshin për shqyrtim, në përputhje me kompetencat e tyre. Duke zbatuar tre kriteret e zhvilluara nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, Kolegji vëren se: (i) gjykatat në marrjen e vendimeve për provat kanë verifikuar rëndësinë që provat e kërkuara nga mbrojtja kanë pasur për objektin e akuzës, ndaj një pjesë e provave të kërkuara nga mbrojtja, ndryshe nga sa pretendon kërkuari, janë pranuar nga gjykatat; (ii) gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme për provat që janë refuzuar, duke evidentuar se përse ato ishin të parëndësishme për objektin e akuzës; (iii) vendimi i tyre për refuzimin e provave nuk ka dëmtuar në mënyrë të përgjithshme procesin e rregullt të zhvilluar ndaj kërkuarit. Gjithashtu, Kolegji çmon se nuk rezulton që gjykatat e zakonshme t'u kenë dhënë vlerë të paracaktuar provave të shqyrtuara, përkundrazi, ato janë vlerësuar në harmoni me njëra-tjetrën. Për rrjedhojë, dukshëm nuk qëndron argumenti i kërkuarit se gjykatat e kanë nisur procesin me bindjen se ai është fajtor për akuzat e ngritura dhe se gjykatat kanë arritur në një konkluzion *apriori* për fajësinë e tij. Për rrjedhojë, edhe pretendimi i ndërlidhur i kërkuarit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është haptazi i pabazuar.

25. Për sa më lart, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit të lidhura me parimin e prezumimit të pafajësisë, janë haptazi të pabazuara.

26. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.